



Akademia e Aviacionit në Vlorë dhe kompania izraelite KAYO, nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për avancimin e arsimit dhe teknologjisë ajrore



faqe 3



GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI, VIZITË ZYRTARE NË ITALI

Me ftesë të shefit të Shtabit të Mbrojtjes të Italisë, gjeneral Luciano Portolano, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjenerallejtënant Arben Kingji zhvilloi një vizitë zyrtare në Itali. Gjatë takimit me gjeneral Portolano, gjenerallejtënant Arben Kingji shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vyer të një vendi mik si Italia për Forcat tona të Armatosura, e cila ka ndikuar në...



faqe 2



PËRFUNDON ME SUKSES STËRVITJA “EAGLE STRIKE 2025”

Pas 10 ditësh stërvitje intensive në zonën e Rreth-Grethit, përfundoi me sukses ushtrimi ndërkombëtar “Eagle Strike 2025”, një demonstrim i qartë i bashkëpunimit të ngushtë mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Gardës Kombëtare të SHBA-ve dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Stërvitja kishte për qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe forcimin e aftësive operacionale...



faqe 4

IN MEMORIAM LAMTUMIRË GJENERAL!

Largimi nga jeta i gjeneralmajorit në pension Kostaq Karoli është një humbje e madhe për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për të gjithë shoqërinë tonë. Me përkushtim të pashoq, profesionalizëm të rrallë dhe integritet të palëkundur, Gjenerali shërbeu me dinjitet për dekada në mbrojtje të atdheut dhe në forcimin...



faqe 9



Ish-Uzina e Autotraktorëve rikthehet në funksion – Qendër e re për prodhimin ushtarak dhe montimin e mjeteve të specializuara

Ish-Uzina e Autotraktorëve në Tiranë do të rigjallërohet në funksion të Industrisë Ushtarake për prodhimin e uniformave dhe montimin e mjeteve të blinduara, transportuesve të artilerisë, zjarrfikëseve dhe autoambulancave.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, nënvizoi se ish-Uzina e Autotraktorëve do të kthehet në funksion, duke u bërë pjesë e programit për sa i përket industrisë ushtarake shqiptare.

“Uzina e Autotraktorëve në fakt ka qenë një nga ndërmarrjet më të rëndësishme industriale të vendit një simbol i fuqisë mekanike shqiptare të dikurshme. Siç e keni parë në disa lajme që janë bërë publike gjatë këtyre muajve, ne jemi duke realizuar një sërë dëgjësash publike në të gjitha ato ish-Uzina Ushtarake apo mekanike si pjesë e të gjithë përpjekjes së qeverisë shqiptare dhe programit për sa i përket industrisë ushtarake”, - tha Vengu.

Vengu theksoi se gjatë dekadës së fundit buxheti i mbrojtjes është rritur ndjeshëm, duke bërë të mundur edhe përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve. Sipas tij, investimet do të mbështesin edhe Policinë e Shtetit dhe Emergjencat Civile.

“Kjo dekadë ka qenë pa dyshim e rritjes së buxheteve ushtarake dhe pikësëpari rritjes së investimeve me një dhjetëfishim të tyre në 10 viteve e fundit. Jo vetëm kaq, rritja e buxheteve të mbrojtjes ka siguruar gjithashtu dhe rritjen e trajtimit financiar të ushtarakëve, përfshirë dhe gjithë komponentët teknikë, inxhinierikë, mekanikë të cilët janë jetësor për sa i përket ambicies tonë për të rijetëzuar industrinë ushtarake në vendin tonë. Dhe arsyeja pse jemi sot së bashku këtu dhe me kolegun e Ministrisë së Brendshme është se strategjia e qeverisë shqiptare sa herë investojmë në kapacitete ushtarake të mund të mbështesim edhe kapacitet që lidhen me Policinë e Shtetit.

Zëvendësministria e Mbrojtjes, pjesë e NATO Youth Summit 2025

Zëvendësministria e Mbrojtjes së Shqipërisë, znj. Blerina Abrazhda, së bashku me presidentin e Malit të Zi, z. Jakov Milatović, morën pjesë si të ftuar nderi në NATO Youth Summit 2025, i cili u mbajt në Budva, Mal i Zi.

Zëvendëssekretarja e Përgjithshme e NATO-s, znj. Radmilla Shekerinska, mirëpriti të rinjtë nga e gjithë Aleanca në këtë samit rinor në Budva.

Në fjalën e saj, zëvendësministria Abrazhda theksoi rëndësinë e sigurisë në Ballkanin Perëndimor dhe rolin kyç të të rinjve në ndërtimin e një të ardhmeje më të sigurt. Ajo theksoi se siguria nuk është thjesht mungesa e konfliktit dhe nuk mund të delegohet, por kërkon investim aktiv në Mbrojtje dhe në institucionet përkatëse. Abrazhda gjithashtu shprehu mirënjohjen ndaj NATO-s për krijimin e një platforme, ku zërat e të rinjve janë në qendër të ndërtimit të sigurisë të së nesërme. NATO Youth Summit 2025 u organizua në bashkëpunim me Këshillin Atlantik të Malit të Zi dhe mbledhi së bashku liderë të rinj nga vendet anëtare dhe partnere të NATO-s, për të diskutuar çështje kyçe të sigurisë globale, përfshirë rolin e NATO-s në ruajtjen e paqes, ndikimin e teknologjive të reja dhe kërcënimet ndaj informacionit.



Gjeneralallejtënant Arben Kingji, vizitë zyrtare në Itali

Me ftesë të shefit të Shtabit të Mbrojtjes të Italisë, gjeneral Luciano Portolano, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH-së, gjeneralallejtënant Arben Kingji zhvilloi një vizitë zyrtare në Itali.

Gjatë takimit me gjeneral Portolano, gjeneralallejtënant Arben Kingji shprehu mirënjohjen për mbështetjen e vyer të një vendi mik si Italia për Forcat tona të Armatosura, e cila ka ndikuar në forcimin e kapaciteteve tona operacionale dhe në rritjen e ndërveprueshmërisë.

Duke i cilësuar si të veçanta marrëdhëniet mes dy vendeve tona, gjeneralallejtënant Kingji u shpreh se kjo reflektohet edhe në bashkëpunimin ushtarak, si në planin dypalësh, në atë rajonal, ashtu edhe në kuadër të Aleancës së NATO-s.

Më tej, gjatë takimit, të dy homologët diskutuan mbi situatën



e sigurisë në rajon e më gjerë, ndërsa vlerësuan se prania e KFOR-it në Kosovë është dhe mbetet e rëndësishme për një rajon të qetë dhe të sigurt.



Gjeneralallejtënant Arben Kingji dhe gjeneral Portolano, gjatë takimit konfirmuan vullnetin për thellimin më tej të këtij bashkëpunimi, si në kuadër

të iniciativave rajonale e stërvitjeve të përbashkëta, po ashtu dhe në frymën e familjes së planeve të Shkurajimit dhe Mbrojtjes së NATO-s.

Akademia e Aviacionit në Vlorë, KAYO firmos marrëveshjen me kompaninë izraelite. Më 8 maj, testi i parë i uljes së avionit në pistën e Aeroportit të Vlorës.

Shkolla e Aviacionit do të rikthehet në Vlorë. Kjo falë bashkëpunimit të kompanisë shtetërore KAYO dhe kompanisë prestigjioze izraelite “Elbit Systems Ltd.”. Memorandumi mes dy kompanive u firmos në Vlorë, në prani të kryeministrit Edi Rama, zëvendëskryeminstres Belinda Balluku, ministrit të Mbrojtjes Pirro Vengu dhe shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjenerallejtënant Arben Kingji.

Memorandumi për rithemelimin e Shkollës u nënshkrua nga drejtuesi i Kompanisë Shtetërore të Prodhimit të Armëve, KAYO, e Ministrisë së Mbrojtjes, Ardi Veliu dhe përfaqësuesit të kompanisë së Izraelit.

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu theksoi se kjo shkollë do të nxjerrë pilotë ushtarë dhe civilë, sipas nevojave të kërkuara.

“Rithemelimi i Shkollës së Aviacionit të Vlorës, në aeroportin e Vlorës, në Akërnë, një shkollë e cila do të gjenerojë jo vetëm pilotë ushtarakë, por edhe civilë, jo vetëm kontrollorë ajrorë ushtarakë, por edhe civilë, gjithmonë me një investim të rëndësishëm të dyanshëm”, - tha ministri Vengu.

“Siç e përmendi edhe zëvendëskryeministrja pak më parë, efekti i rritjes së buxhetit të mbrojtjes në tërë këtë dekadë, do të doja të theksoja një shifër të vetme, në dhjetë vitet e ardhshme investimet në mbrojtje në Republikën e Shqipërisë janë 10-fishuar, nga 13 milionë në 138 milionë euro”, - tha Vengu. “Sigurisht, - shtoi ai, - Shqipëria në përmbushje të të gjithë detyrimeve si vend anëtar i NATO-s ka investuar në infrastrukturë kritike ushtarake, por jo vetëm, dhe ndërkohë që ne ndërmarrim një hap tjetër ambicioz për të çuar edhe më lart se 2% të prodhimit të brendshëm bruto, buxhetin e mbrojtjes në tërësi, përpiqemi që gjithmonë këto investime të kenë një impakt në ekonominë e vendit, një vlerë të shtuar në ekonominë e vendit, dhe prandaj kemi një logjikë në investimet në infrastrukturë kritike, në mënyrë që ato të kenë një dobi të dyfishtë: të shërbejnë për lëvizshmërinë ushtarake, por edhe për lëvizshmërinë civile.

I tillë është në fakt edhe i gjithë investimi në Korridorin 8, ku porti i Porto Romanos është porta hyrëse dhe do të jetë, siç tha zëvendëskryeministrja, një port ushtarak dhe civil: një port tregtar modern i automatizuar dhe një port ushtarak që do të ketë një dobi



Akademia e Aviacionit në Vlorë dhe kompania izraelite KAYO, nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi për avancimin e arsimit dhe teknologjisë ajrore

të trefishtë akomodimin e mjeteve detare që forca detare, që Shqipëria do të ndërtojë, dhe akomodimin e forcave të NATO-s për dislokime”, - tha ministri Vengu. “Por, - shtoi ai, - infrastruktura nuk është e vetmja shtyllë. Shtylla e dytë ka të bëjë me investime në kapitalin njerëzor, zhvillimi i industrisë së mbrojtjes, qëndrueshmëria e infrastrukturës kërkojnë kapacitete dhe burime njerëzore të mirë kualifikuara, prandaj dhe kemi ndërmarrë, Akademia e Forcave të Armatosura së bashku me Universitetin Politeknik dhe Universitetin e Vlorës, krijimin e programeve të përbashkëta në mënyrë që të mbështesim këtë sforcë dhe përpjekje kombëtare për industrinë ushtarake”.

“Na duhet të stërvitim inxhinierë navalë, inxhinierë armatimi, kontrollorë ajrorë, pilotë, e kështu me radhë, në të gjithë ciklin e investimeve publike, ne na duhet të ndërtojmë një gjeneratë ekspertize, profesionistë të rinj, të cilët mirëmbajnë këtë infrastrukturë kritike dhe e zhvillojnë më tej.

Prej disa muajsh Ministria e Mbrojtjes dhe kompania e prodhimit ushtarak KAYO, kanë një negociatë me një kompani lider izraelite “LB Systems”, që i kemi prezent këtu sot për të gjeneruar këto kapacitete, këto burime njerëzore civilo-ushtarake, ndaj do të doja të kalonim tek momenti i nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje shumë të rëndësishme për rithemelimin e shkollës së aviacionit në Vlorë, në aeroportin

e Vlorës, një shkollë e cila do të gjenerojë jo vetëm pilotë ushtarakë, por edhe pilotë civilë, jo vetëm kontrollorë ajrorë ushtarakë, por edhe civilë, gjithmonë me një investim të dobishëm të dyfishtë”, - tha Vengu.

KAYO, pas nisjes së bashkëpunimit të suksesshëm me “Fincantieri” për ndërtimin e anijeve në Pashaliman, po merr përsipër edhe këtë projekt të rëndësishëm me “Elbit Systems”, kompania prestigjioze që sjell teknologji të përparuar, si simulatorë të fluturimit në kushte të vështira dhe pajisje moderne trajnimi.

Ngritja e Akademisë së Aviacionit do të sjellë ulje të kostove, certifikim të qëndrueshëm dhe të pavarur si edhe rritje të kapaciteteve kombëtare në mbrojtje dhe aviacion civil.

Ministri Vengu: Mbështetja e SHBA-ve, përmes donacioneve në armatim dhe pajisje, gur themeli për modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve tona operacionale

Forcimi i sigurisë kombëtare është i lidhur kryesisht me trajnimin e vazhdueshëm dhe bashkëpunimin me aleatët tanë strategjikë. Në kuadër të vizitës së përfaqësuesve të Kongresit amerikan, në Qendrën Stërvitore të Forcës Tokësore, u zhvillua një demonstrim i qitjes në kushte simulimi nga një skuadër e specializuar, si dhe një ekspozim statik i armatimit, pajisjeve dhe mjeteve të përdorura nga Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë (BKL) dhe Qendra e Mbrojtjes nga



Armët e Dëmtimit në Masë (QMADM); nga ku Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, bëri të ditur se: “Mbështetja e vazhdueshme e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përmes donacioneve në armatim dhe pajisje, është një gur themeli për modernizimin dhe fuqizimin e kapaciteteve tona operacionale, theksoi Vengu.

Sipas tij, ky partneritet forcon jo vetëm mbrojtjen tonë, por edhe kontributin e Shqipërisë në sigurinë rajonale dhe globale.

Përfundon me sukses stërvitja “Eagle Strike 2025”

Pas 10 ditësh stërvitje intensive në zonën e Rreth-Grethit, përfundoi me sukses ushtrimi ndërkombëtar “Eagle Strike 2025”, një demonstrim i qartë i bashkëpunimit të ngushtë mes Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Gardës Kombëtare të SHBA-ve dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Stërvitja kishte për qëllim rritjen e ndërveprueshmërisë dhe forcimin e aftësive operacionale të studentëve ushtarakë në situata reale në nivel taktik.

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj, falënderoi trupat pjesëmarrëse për profesionalizmin dhe përkushtimin e treguar, ku ndër të tjera citoi:

“Faleminderit të gjithë pjesëmarrësve për profesionalizmin, përkushtimin dhe shpirtin e bashkëpunimit që e karakterizoi këtë stërvitje. Kontributi juaj ishte thelbësor për suksesin e ‘Eagle Strike 2025’. Kjo stërvitje nuk ishte thjesht një test i aftësive tona taktike, por një dëshmi e vlerave që ndajmë si partnerë me besim, përgjegjësi dhe përkushtim ndaj paqes dhe sigurisë. Ju jeni ambasadorët më të mirë të këtij bashkëpunimi ndërkombëtar”. Në fund të ceremonisë, pjesëmarrësve iu shpërndanë certifikata mirënjohjeje në shenjë vlerësimi për kontributin e tyre.



EOD përfundon një tjetër operacion për pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme, në bashkinë Durrës

Efektivët e Batalionit të Xhenios kanë përfunduar një tjetër detyrë në mbështetje të emergjencave civile në bashkinë Durrës, për pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme.

Ekipi EOD i angazhuar në operacion, bëri rrethimin e perimetrit të zonës së operacionit dhe konstatoi se municioni i gjetur pranë portit në qytetin e Durrësit, ishte predhë luftarake, e cila i përkiste periudhës së Luftës së Dytë Botërore.

Përmes njohurive të fituara në trajnime brenda dhe jashtë vendit si dhe falë eksperiencës së krijuar gjatë detyrave të ndryshme EOD, kryeoperatori vlerësoi se municioni ishte i prekshëm dhe i lëvizshëm, duke bërë më pas transportimin e tij për t'u magazinuar në depot përkatëse.

Efektivët e Batalionit të Xhenios kanë përbushur me sukses një tjetër mision në shërbim të sigurisë publike.

Vizitë e ekipit amerikan të mirëmbajtjes së helikopterëve në Bazën Ajrore Farkë

Në Bazën Ajrore Farkë, një ekip i ushtrisë amerikane zhvilloi një vizitë dy ditore. Kjo vizitë u realizua në kuadër të bashkëpunimit me task forcën e aviacionit të NATO-s në Kosovë, ku vazhdimisht që nga muaji gusht 2024, trajnohen ekipet tona të mirëmbajtjes së helikopterëve “Blackhawk”.

Gjatë vizitës, ata u njohën me procedurat e mirëmbajtjes së helikopterëve “Blackhawk” në Bazën Ajrore Farkë, duke vlerësuar pozitivisht bashkëpunimin dhe angazhimin tonë.

Gjithashtu, ky ekip dha ndihmesën e tij me pajisje të nevojshme për inspektimet në vazhdimësi të helikopterëve “Blackhawk” dhe ndanë eksperiencat e tyre me mekanikët tanë, duke sjellë një ekspertizë të avancuar dhe përvojë ndërkombëtare në terren.

Ky bashkëpunim u vlerësua pozitivisht edhe nga ana e zyrës së ODC-së në vendin tonë dhe u konfirmua mbështetja maksimale dhe e vazhdueshme e kësaj zyre për projektin e blerjes nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes.

Përveç mirëmbajtjes, ekipi merr pjesë në trajnime të përbashkëta me forcat e tjera të NATO-s, duke rritur ndërveprimin dhe gatishmërinë për çdo lloj misioni, nga operacionet ajrore deri te ndihma emergjente në terren.




Forca Tokësore nis Kontingjentin KFOR - 3 në Kosovë

Forca Tokësore nisi Kontingjentin KFOR - 3 në Kosovë, për përcjelljen e trupave nga Batalioni i Këmbësorisë së Lehtë (bkl), të cilët do të shërbejnë në KFOR, si pjesë e misionit të NATO-s. Me këtë rast u organizua një ceremoni në të cilën mori pjesë shefi i Shtabit të Forcës Tokësore, kolonel Ilirjan Dauti, i cili pasi u uroi suksese, ndër të tjera vuri theksin në zbatimin e detyrës me rigorozitet dhe përfaqësimin dinjitoz të Shqipërisë, tashmë si një prodhuese e mbrojtëse e sigurisë në rajon e më gjerë.

Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit, komandanti i kontingjentit, kapiten Erind Pashaj, i cili pasi falënderoi për besimin e treguar i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe korrektesë në çdo drejtim.

Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale së bashku me aleatët tanë ndërkombëtarë, në përfaqësimin sa më denjësisht të Forcave tona të Armatosura.



FORCAT E REGJIMENTEVE TË KËMBËSORISË NË JUG
DHE VERI: ORGANIZIMI DHE AFTËSIA LUFTARAKE





AI, si faktor strategjik global

AI-ja po trajtohet sot si një aset strategjik kombëtar, njësoj si energjia bërthamore apo teknologjia hapësinore dikur. Shtetet që arrijnë të zotërojnë ose dominojnë teknologjitë e AI-së mund të fitojnë avantazh të jashtëzakonshëm ekonomik, ushtarak dhe diplomatik.

SHBA

Lider në inovacion për shkak të ekosistemit të kompanive të teknologjisë (Google, OpenAI, Microsoft, Meta).

Avantazh në kapitalin njerëzor dhe qasjen ndaj të dhënave cilësore.

Politikat publike për AI-në janë në zhvillim, me fokus në etikë dhe transparencë.

Kina

Objektiv kombëtar: të bëhet lider botëror në AI deri në 2030.

Avantazh në mbledhjen masive të të dhënave (për shkak të modelit autoritar).

Fokus në aplikimet për mbikëqyrje, kontroll shoqëror, dhe zbatime ushtarake.

Investime të mëdha shtetërore në infrastrukturë dhe R&D.

Kjo përplasje teknologjike është një “Luftë e Ftohtë Dixhitale”, ku AI është arma kryesore.

Përdorimi i AI-së në mbrojtje dhe siguri

Autonomi në armë: dronë inteligjentë, sisteme mbrojtëse të automatizuara, identifikim i objektivave në kohë reale.

Luftë kibernetike: përdorimi i AI-së për të kryer sulme ose për të mbrojtur rrjete strategjike. Analiza e inteligjencës AI përdoret për të analizuar sasi të mëdha të të dhënave nga satelitët, media sociale, etj. Vendet me AI të avancuar kanë superioritet të informacionit, një përparësi vendimtare në konfliktet moderne.



LUFTË KIBERNETIKE: PËRDORIMI I AI-SË PËR TË KRYER SULME OSE PËR TË MBROJTUR RRJETE STRATEGJIKE. ANALIZA E INTELIGJENCËS AI PËRDORET PËR TË ANALIZUAR SASI TË MËDHA TË TË DHËNAVE NGA SATELITËT, MEDIA SOCIALE, ETJ. VENDET ME AI TË AVANCUAR KANË SUPERIORITET TË INFORMACIONIT, NJË PËRPARËSI VENDIMTARE NË KONFLIKTET MODERNE.

AI dhe dominimi ekonomik

Automatizimi industrial: vendet me AI të zhvilluar do të kenë produktivitet më të lartë dhe avantazh konkurrues në tregjet globale.


Transformimi i fuqisë punëtore: vendet që nuk përshtatin sistemet arsimore dhe politikat ekonomike do të përballen me destabilitet social dhe emigracion ekonomik, firmat e mëdha të AI-së (p.sh. OpenAI, Baidu, Alibaba Cloud) mund të diktojnë rregullat ekonomike globale.

Gjeopolitika e rregullimit të AI-së

Rregullat globale janë ende të paqarta, dhe vendet përpiqen të vendosin standarde që u favorizojnë interesat. BE-ja, përpiqet të vendosë rregulla etike dhe mbrojtje të të dhënave. SHBA-të, më fleksibël ndaj inovacionit, por po ndërton korniza për transparencë dhe kontroll të rrezikut. Kina, e përdor rregullimin për të kontrolluar lirinë e fjalës dhe për të centralizuar pushtetin.

Pozicioni i Ballkanit dhe Shqipërisë

Rajoni është konsumator i AI-së, jo prodhues. Potencial për



të shfrytëzuar AI-në në shërbimet publike, arsim, shëndetësi, dhe siguri kibernetike.

Reziku: mungesa e kapaciteteve rregullatorë dhe humbja e sovranitetit dixhital, nëse teknologjia importohet pa kuptuar rreziqet.

Skenarë të mundshëm gjeopolitikë

Zhvillimi i AI-së po rikonfiguron fuqinë globale, me ndikime që shtrihen nga ekonomia në siguri, e deri te modeli i qeverisjes. Vendet që nuk përshtaten do të marginalizohen, ndërsa ato që investojnë në arsim, rregullim dhe inovacion do të kenë rol dominues në rendin e ri botëror.

Zhvillimi i inteligjencës artificiale (AI) ka dy anë kryesore që shpesh diskutohen në nivel teknik, etik dhe shoqëror:

Ana Pozitive (Përparësitë e AI-së)

Automatizimi dhe efikasiteti: AI-ja mund të automatizojë detyra të përsëritshme, duke rritur produktivitetin dhe kursyer kohë. Përmirësimi i vendimmarrjes: Algoritmet

mund të analizojnë sasi të mëdha të të dhënave dhe të ofrojnë rekomandime të sakta për bizneset, mjekësinë, financat, etj. Zbulime shkencore dhe teknologjike: AI-ja po ndihmon në përsheptimin e kërkimeve në bioteknologji, klimë, hapësirë dhe fusha të tjera. Asistenca për njerëzit me nevoja të veçanta: Teknologjitë e bazuara në AI mund të ndihmojnë persona me aftësi të kufizuara, për shembull me zë, përkthim automatik, ose mjete të tjera ndihmëse. Përmirësimi i shërbimeve publike: Në arsim, shëndetësi, transport dhe administratë, AI-ja mund të ofrojë shërbime më të shpejta dhe më të personalizuar.

Ana Negative (Rreziqet dhe Sfidat e AI-së)

Humbja e vendeve të punës: Automatizimi mund të zëvendësojë shumë punëtorë, veçanërisht në sektorët e industrisë dhe shërbimeve. Privatësia dhe mbikëqyrja: AI-ja përdoret për mbledhje dhe analizim të të dhënave personale, shpesh pa dijeni ose miratim të individëve. Pabarazia dhe diskriminimi: Modelet e AI-së mund të përforcojnë paragjykime ekzistuese

nëse trajnohen me të dhëna të njëanshme. Manipulimi dhe dezinformimi: Teknologjitë si “deepfake-s” dhe sistemet që gjenerojnë tekste mund të përdoren për propagandë ose mashtrime. Kontrolli dhe siguria: Nëse AI-ja bëhet shumë autonome, mund të dalë jashtë kontrollit ose të përdoret për qëllime të dëmshme (si armët autonome).

Inteligjenca artificiale (AI) po e ndryshon ndjeshëm mënyrën se si njeriu mendon, percepton botën dhe ndërvepron me të. Ja disa nga mënyrat kryesore se si AI-ja po ndikon në mendimin njerëzor:

Ndikimi në Procesin Vendimmarrës

Më shumë varësi nga makinat: Njerëzit po mbështeten gjithnjë e më shumë te algoritmet për vendime të përditshme, që nga blerjet online deri te diagnozat mjekësore.

Zbehja e vetëbesimit personal: Kur AI-ja jep zgjidhje të menjëhershme dhe të sakta, njerëzit mund të fillojnë të dyshojnë në gjykimin e tyre.

Ndryshimi i Perceptimit për Inteligjencën

Rishikim i kufirit “njeri-makinë”: AI-ja që shkruan, pikturon, madje edhe kompozon muzikë, po sfidon idenë se kreativiteti është vetëm cilësi njerëzore.

Debate filozofike dhe ekzistenciale: Njerëzit po pyesin veten: Çfarë na bën neve të veçantë? Dhe a është vetëdija vetëm çështje procesimi të dhënash?

Ndikimi në Ndërveprimet Shoqërore

Komunikim i ndikuar nga AI-ja: Shërbimet si chatbotët, asistentët virtualë dhe algoritmet e rrjeteve sociale po formësojnë mënyrën se si bisedojmë dhe përjetojmë informacionin. Në disa raste, njerëzit ndihen më të afërt me makinat sesa me njerëzit realë, sidomos me AI të personalizuar si asistentët virtualë apo botët shoqërore.

Ndikimi në Mësim dhe Kreativitet

Mësim pasiv, me AI-në që “e bën punën” (shkruan ese, zgjidh detyra), nxënësit rrezikojnë të humbasin aftësinë për të menduar kritikisht dhe për të analizuar vetë.

Nga ana tjetër, AI-ja mund të shërbejë si mjet që zgjeron aftësinë tonë mendore, duke na ndihmuar të eksplorojmë ide që më parë ishin jashtë mundësive tona.

Ndryshimi i Ritmit të Reflektimit

Mendim më i shpejtë, më pak i thellë: Me AI-në që jep përgjigje të menjëhershme, njerëzit kanë më pak durim për të reflektuar thellësisht ose për të kërkuar të vërtetën përmes analizës.

AI-ja po transformon mendimin njerëzor, duke na ofruar ndihmë të fuqishme, por gjithashtu duke rrezikuar që të humbim disa nga aftësitë dhe thellësitë tona mendore.



Lamtumirë Gjeneral!

Largimi nga jeta i gjeneralmajorit në pension Kostaq Karoli është një humbje e madhe për Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe për të gjithë shoqërinë tonë.

Me përkushtim të pasqor, profesionalizëm të rrallë dhe integritet të palëkundur, Gjenerali shërbeu me dinjitet për dekada në mbrojtje të atdheut dhe në forcimin e kapaciteteve ushtarake të vendit tonë.

Kostaq Karoli ishte një njeri me dimensione kombëtare. Ai mishëroi në vete figurën e oficerit të përkushtuar, drejtuesit të drejtë dhe qytetarit të ndershëm. Gjatë gjithë karrierës së tij, ai udhëhoqi me mençuri, frymëzoi me shembullin personal dhe kontribuoi në ndërtimin e një ushtrie moderne, të përgatitur dhe të përkushtuar ndaj misionit kushtetues.

I respektuar nga vartësit, kolegët dhe drejtuesit e tij, gjeneralmajor Kostaq Karoli nuk ishte vetëm një figurë ushtarake, ai ishte mësues i brezave të rinj, mik i sinqertë dhe njeri që gjithmonë vendoste interesin kombëtar mbi gjithçka tjetër.

Në emër të ish-bashkëpunëtorëve të tij, i shprehim ngushëllimet më të ndjera familjes për humbjen e bashkëshortit dhe babait të përkushtuar, të mikut të rrallë dhe të ushtarakut shembullor.

Portreti i një Gjenerali me gjurmë të thella në FA

Gjeneralmajor Kostaq Karoli, ish-shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë shqiptare, u lind më 14 dhjetor 1945. Në vitet 1959-’63 vazhdoi shkollën e mesme ushtarake “Skënderbej”, ndërsa në vitet ’63-’65 ndoqi studimet në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve.

Në vitet 1975-’77 vazhdoi Akademinë e Mbrojtjes, ndërsa në vitin 1986 përfundoi kursin e Shtatmadhorisë. Do vazhdonte me kurse të ndryshme kualifikimi si: për matematikë, psikologji, për problemet e stërvitjes etj.

Si kualifikime të më pasme vijjnë: Grada shkencore “Doktor” dhe titulli “Profesor”, ndërkohë që ishte dhe autor i dy librave dhe bashkautor në dhjetëra tekstesh, metodikash e artikujsh të ndryshëm.

Gjeneralmajor (R) Kostaq Karoli, figurë e njohur dhe e nderuar në historinë moderne të ushtrisë shqiptare, lindi në një periudhë të vështirë për vendin, por me pasion dhe përkushtim ndërtoi një karrierë të gjatë në shërbim të mbrojtjes kombëtare. U diplomua me rezultate të larta në institucionet ushtarake të kohës dhe ndoqi trajnime të shumta brenda dhe jashtë vendit, duke përfaqësuar Shqipërinë me nder në çdo detyrë që i besoj.

Me ngritje të vazhdueshme në hierarkinë ushtarake, ai mbajti poste të rëndësishme drejtimi dhe dha një kontribut të veçantë në proceset e reformimit dhe profesionalizimit të Forcave të Armatosura pas viteve ’90.

I njohur për qetësinë në vendimmarrje, korrektësinë institucionale dhe aftësinë për të motivuar të tjerët, Gjeneralmajor Karoli mbetet një nga figurat që lanë gjurmë të thella jo vetëm në strukturat e ushtrisë, por edhe në kujtesën e gjithë atyre që e njohën.

U nda nga jeta, më 28 prill 2025.

Qoftë i përjetshëm kujtimi i tij!



Gjeneralmajor (R) Kostaq Karoli



KOSTAQ KAROLI ISHTE NJË NJERI ME DIMENSIONE KOMBËTARE. AI MISHËROI NË VETE FIGURËN E OFICERIT TË PËRKUSHTUAR, DREJTUESIT TË DREJTË DHE QYTETARIT TË NDERSHËM. GJATË GJITHË KARRIERËS SË TIJ, AI UDHËHOQI ME MENÇURI, FRYMËZOI ME SHEMBULLIN PERSONAL DHE KONTRIBUOI NË NDËRTIMIN E NJË USHTRIE MODERNE, TË PËRGATITUR DHE TË PËRKUSHTUAR NDAJ MISIONIT KUSHTETUES.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Shqiptarë, fluturoni drejt dritës! Thirrja hyjnore që na ngarkon me shpresë dhe përgjegjësi



Urdhri hyjnor i ATIT të Shenjtë, Papa Françesku, mision i shoqërisë shqiptare: “Në krahët e shqiponjës dhe shpirtin e Nënë Terezës!”

Në një botë që shpesh humb drejtimin mes zhurmave të interesave dhe errësirës së pasigurisë, zëri hyjnor i Papës kumbon si një kabanë shprese mbi qiellin shqiptar: “Shqiptarë, fluturoni drejt dritës!”.

Nuk është thjesht një fjalë e bukur për të mbushur faqe gazetash. Është një thirrje që përshkon thelbin e qenies sonë kombëtare, që fton çdo shqiptar, kudo që ndodhet, të mos ndalet në gjysmën e rrugës, por të ngrihet më lart, më larg, drejt të mirës, drejt së vërtetës, drejt dritës.

Në historinë tonë të stuhishme, ndër plagë të hapura dhe lot të padukshëm, kemi mbajtur në gjoks një dritë të brendshme që as dhuna, as varfëria, as harrimi nuk mundën ta shuajnë. Dhe sot, kjo thirrje hyjnore vjen si një konfirmim: Ju, shqiptarë, jeni krijuar për të fluturuar, jo për të zvarritur në baltën e dëshpërimit.

Ati Hyjnor njuh plagët dhe forcën tonë

Papa, si një AT shpirtëror për mbarë njerëzimin, e njihte shpirtin e popullit tonë, ai e dinte se sa shumë kemi sakrifikuar për lirinë, sa shumë kemi qëndruar në këmbë, edhe kur dukeshim të rrënuar, se zemra shqiptare nuk dorëzohet lehtë. Prandaj, thirrja e tij nuk ishte një ftesë për arratisje nga vështirësitë, por një thirrje për një ringjallje morale, një ngjitje shpirtërore, një rindërtim të shpresës.

Në një kohë kur shumë kombe përkulen para tundimeve të humbjes së identitetit, ATI me shpirtin e madh dhe të dëlirë na këshilloi: “Ruani dritën tuaj, ruani shpirtin tuaj, ruani veten tuaj!”. Drita, nuk është abstrakte, ajo është vetë realiteti që mund të ndërtojme: një Shqipëri më të drejtë, një shoqëri më njerëzore, një komb që nuk mbijeton thjesht, por lulëzon në dinjitet dhe bashkim.

Drita është në trimërinë për të mbrojtur të vërtetën, në urtësinë për të ndërtuar paqe, në forcën për të hedhur tutje korrupsionin, padrejtësinë, ndarjet e kota.

Drita është në fuqinë tonë për të kthyer besimin tek njëri-tjetri, për të kthyer Shqipërinë në një tokë ku e ardhmja nuk shihet me frikë, por me krenari.

Një thirrje për secilin prej nesh

“Fluturoni drejt dritës” është një urdhër për të gjithë: nga fëmijët që sapa mësojnë për flamurin e tyre, tek të rinjtë që kërkojnë rrugën e tyre në këtë botë të trazuar; nga punëtorët e thjeshtë që mbajnë në supe jetën e përditshme, tek intelektualët që kanë misionin të ndriçojnë mendjet.

Është një thirrje që kërkon përgjigje me vepra, jo me fjalë: Të ngrihemi mbi vetveten, të mos i lejojmë plagët e historisë të na robërojnë shpirtin. Të mos jetojmë me mendjen në ikje, por me zemrën në ndërtim.

Fjalët që bëhen amanet

Le ta dëgjojmë këtë thirrje, jo si një kalimtar i zakonshëm që kalon rrugës dhe nuk ndalet. Le ta mbajmë në zemër, si një amanet që e lëmë trashëgim brezave të ardhshëm; Shqiptarë, fluturoni drejt dritës! Lart! Me krenarinë e të parëve tanë që e deshën këtë tokë deri në fund. Lart! Me forcën që vetëm një popull si yni mund të ketë. Drita është atje ku duam të shkojmë. Është ajo për të cilën ia vlen të jetojmë, të luftojmë, të ndërtojmë.

Dritë mbi plagët tona

Prej shekujsh, kombi ynë është bërë dëshmitar dhe pjesëmarrës në betejën mes errësirës dhe dritës. Nga luftërat për liri, tek përpjekjet për mbijetesë dhe ndërtim, shqiptarët kurrë nuk e kanë humbur besimin në dritën e shpresës, edhe kur retë e zeza kanë mbuluar qiellin.

Papa e njuh këtë histori. Ai na njuh si një popull që ka duruar më shumë se ç’mund të përshkruhet, por që kurrë nuk është dorëzuar.

Fjalët e tij janë një reflektim i njohjes së kësaj force: një thirrje për ta ngritur këtë shpirt të palodhur, këtë karakter të çeliktë, në një nivel të ri — në fluturim drejt dritës.

Mesazhi si amanet

“Fluturoni drejt dritës” nuk është një fjalë metaforike. Nuk është një ndjesë kalimtare. Është një mision. Një

përkushtim për të lënë pas pesimizmin, dëshpërimin, ndasitë boshe, dhe për të ndërtuar një shoqëri ku drita të jetë drejtësia, ndershmëria, dashuria për atdheun dhe vëllazëria mes shqiptarëve.

Drita është vetë Shqipëria që duam të shohim: një vend ku dinjiteti njerëzor respektohet, ku puna vlerësohet, ku besimi në të ardhmen nuk është ëndërr, por realitet. Kush nuk fluturon drejt dritës, do të fundoset në errësirë. Ne nuk mund të mbetemi asnjëherë.

Detyra e brezit tonë

Sot, brezi ynë është përballë një sfide historike. Jo më beteja klasike të pushkës dhe gjakut, por beteja më e vështirë: ajo e karakterit, e ndërtimit, e bashkimit.

Të fluturosh drejt dritës do të thotë të mos i nënshtrohesh korrupsionit që helmon shpirtin, të mos pranosh varfërinë shpirtërore që shuan idealet, të mos përkulesh para padrejtësive. Fluturimi drejt dritës fillon me ndërrimin e mendësisë: nga fatalizmi në optimizëm; nga ndarja në bashkim; nga shkatërrimi në ndërtim. Kjo është epoka që na thërret të mos jemi thjesht dëshmitarë, por protagonistë të një rilindje kombëtare.

Në këto kohë kur bota endet mes trazirash shpirtërore dhe përpjekjesh të ethshme për drejtësi, një thirrje e fuqishme mbërriti deri në ne, shqiptarëve: “Fluturoni drejt dritës!”. Ishte zëri i Papës, një zë që nuk njuh mure, që tejkalon gjuhë, kombe dhe histori, për të prekur shpirtin e njerëzimit.

Por mbi të gjitha, ishte një thirrje drejtuar një populli që ka ditur të jetojë, të vuajë dhe të shpresojë në heshtje — shqiptarëve.

Ishte një ftesë hyjnore për të mos harruar kurrë rrënjët, për të mos lejuar që era e së keqes të shkulte farën e së mirës që ndodhet në ne.

Papa na shihte jo si viktimë të historisë, por si bij të dritës, si mbartës të një misioni të shenjtë: të ecim përpara, të ndriçojmë, të rilindim.

Emocioni i një kombi

Kur shqiptari dëgjoj këtë thirrje, zemra e tij njohu veten. Në këto fjalë u pasqyrua gjithë rruga jonë e mundimshme: nga trimëria e maleve të lirisë, nga këngët që kanë mbajtur gjallë shpirtin në errësirat e pushtimeve, nga lotët e nënave

që mbështeteshin tek shpresa për një të nesërme më të ndritur.

Ne jemi populli që kemi ecur nën hijen e perandorive dhe sërish kemi ngulur këmbë në trojet tona.

Ne jemi ata që, edhe kur bota na harroi, ruajtëm në gjoksin tonë flakën e besimit. një pasqyrë e shpirtit tonë: një shpirt që nuk pranon të mbetet rob i së kaluarës, një shpirt që kërkon të ngjitet lart, drejt burimit të jetës — dritës. “Fluturoni drejt dritës!”, nuk është një këshillë për të ikur nga vështirësitë, është një thirrje për ta përballuar realitetin me forcë, për të ndërtuar një shoqëri që mbështetet mbi vlera të vërteta: mbi dashurinë për jetën, mbi respektin për tjetrin, mbi ndershmërinë dhe besimin; Një thirrje, për të mos mbetur peng i errësirës së historisë sonë të përgjakshme, të mos biem pre e pesimizmit, të mos dorëzohemi para sfidave.

Drita si qëllim dhe rrugë

Drita, fillon tek ne — në familjet tona, në arsim, në respektin për ligjin, në mbrojtjen e së vërtetës, në mbështetjen e më të dobët. Ajo është në fjalën e ndershme, në veprën e mirë, në besimin se një popull mund të ndërtojë të ardhmen e tij pa u dorëzuar para errësirës së korrupsionit, urrejtjes, ndarjes dhe mungesës së shpresës.

Shqiptarë, kjo thirrje është një dhuratë, por edhe sfidë. Ajo na ngarkon me një përgjegjësi të shenjtë: të mos harrojmë se mbi ne ndriçon një dritë e veçantë, që ka lindur nga vuajtjet dhe që kërkon të shndërrohet në bekim.

Tani është koha jonë. Tani është momenti të zgjohemi nga letargjia, të shkundim pluhurin e të kaluarës dhe të fluturojmë lart, drejt asaj drite që Papa e sheh si fatin tonë.

Një thirrje që mbetet

Le të mos jetë kjo thirrje një kujtim i bukur që shuhet me kalimin e kohës. Le të bëhet ajo flamuri ynë i përditshëm, ftesa që na zgjon çdo mëngjes, besimi që na udhëheq në çdo hap.

Nëse çdo shqiptar zgjedh të fluturojë drejt dritës, atëherë drita nuk do të jetë një realitet i ndritshëm për ne, për fëmijët tanë, për të gjithë brezat që do të vijnë.

‘Shqiptarë, fluturoni drejt dritës! Jo vetëm sepse është një thirrje hyjnore, por sepse është thirrja e zemrës sonë të përjetshme!’.

Dibra, thesar i gjallë i kulturës shqiptare – Trashëgimia që frymëzon brezat

Zakonet shqiptare ndryshojnë sipas krahinave historike dhe janë formuar nën ndikimin e topografisë, historisë, besimeve fetare dhe strukturës shoqërore të secilës zonë. Ja disa shembuj për ta ilustruar këtë ndarje:

Veriu i Shqipërisë (Malësia e Madhe, Tropoja, Dukagjini, Puka)

Kanuni dhe e Drejta Zakonore

Zakonet rregullohen nga Kanuni i Lekë Dukagjinit. Vlera si besa, nderi, mikpritja dhe hakmarrja kanë qenë thelbësore. Organizimi i jetës shoqërore bëhej përmes fisit.

Dasmat në Veri

Karakterizohen nga solemnitet dhe ceremoni shumë tradicionale. Vajza shpesh këndohej me këngë vajtuese para se të largohej nga familja.

Veshja: Tirq të zinj, çakshirë, plis i bardhë dhe opinga për burrat. Gratë përdorin xhubletën, një nga veshjet më të vjetra në Evropë. Zona e Shqipërisë së Mesme (Tirana, Elbasani, Dibra, Kruja).

Zakone më të ndërthurura

Ndikim i dyfishtë: nga veriu dhe jugu, por me elemente të vetat urbane.

Elbasani njihet për Ditën e Verës, që është një zakon pagan i lashtë, i lidhur me rigjallërimin e natyrës.

Muzika dhe Këngët

Këngët e dasmave janë të gëzueshme dhe shpesh me tekst humoristik.

Traditat dhe zakonet

Dasma dibrane: Një kod i përpiktë, nga batutat e deri tek gjobat dhe roli i dajave

Dasma, lindja e vdekja edhe në këtë krahinë të Shqipërisë, patjetër që kanë veçantitë e tyre, ritet dhe zakonet e shumta, që sigurisht nuk pretendojmë t’i zbulojmë sot deri tek e fundit... Ashtu si në ditët e sotme, ku para kurorëzimit vajza dhe djali pyeten nëse do ta duan njëri-tjetrin “në të mirë e në të keqe”, “në hidhërim e gëzime”, për t’u betuar më pas para Zotit, edhe në atë kohë, në Dibër, para imamat apo shehut, çiftit i bëhej e njëjta pyetje.

Për sa i përket pajës së nuses, për dibranët ajo nuk ka qenë tepër e rëndë: “Dy ose tri veshje komplet për nusen, ishin të detyrueshme në çdo rast. Por, kërkesat nga ana e shtëpisë së dhëndrit mund të shkonin deri në 7 apo 8 palë veshje, gjë që në atë kohë e rëndonte tepër familjen e nuses. Stolitë e nuses ishin napolonat e varura në qafë e në veshje, si dhe monedhat e vjetra turke që shpoheshin dhe përdoreheshin në vend të vathëve. Dhuratat e para, shenja të fejesës, ishte shamia ose shalli për vajzën dhe riza për djalin.

Më vonë piheshin kafet në të dyja shtëpitë dhe vendosej dita e martesës. Krushqit marrin nusen: Gjithmonë, për të marrë nusen, krushqit e dhëndrit shkonin në numër tek. Do të ishin 7, 9, 13 ose 15 vetë, jo më tepër. Nga krushqit, tre prej tyre duhet të ishin shumë të përgatitur ose siç thotë populli “të rrahur me vaj e me uthull”. Njëri prej tyre nevojitej të ishte shumë i mençur e me përvojë të madhe, tjetri duhej të ishte me xhepat plot me pare, pasi “mund të gjobiteshin” nga krushqit e nuses. Ndërsa i treti kryesor i krushqve të dhëndrit, duhej të zgjidhej “trim e sypatrembur”, në mënyrë që nëse teprohej me ngacmimet nga krushqit e nuses ose nga daja (që mund të kërkonte para shumë) ai të vepronte duke iu kërcënuar atyre. Të gjithë këta krushq që shkonin për të marrë nusen, ishin burra. Nusja mbulohej me duvak dhe me flamurin kombëtar. Atë e shoqëronin vëllezërit dhe nuni apo kumbari. As lodrat apo veglat e tjera muzikore që kishin, nuk binin derisa nusja futej në kufirin e fshatit të dhëndrit. Atje i prisnin në hyrje të fshatit të gjithë me gëzim, lodra e këngë. Në raste të rralla, ndodhnin edhe ngatërresa, sidomos kur takoheshin dy palë krushq. Në këto raste, njëra palë duhej të hapte rrugën dhe tjetra të kalonte, e duke mos lëshuar asnjëri fill, kanë ndodhur edhe vrasje. Madje, në fshatin Shuman, gjendet një episod i habitshëm natyror me 22 gurë përballë njëri-tjetrit (11 në secilën anë) dhe një gur të 23-të të veçuar. Për 11 gurët e anës së majtë, të gdhendur nga natyra, njerëzit thonë se janë krushqit e gurëzuar, ndërsa në anën matanë ndodhet një gur i përkulur, për të cilin thonë se është nusja. E çuditshme është, se dhe në krahun tjetër janë 11 gurë. Tregojnë, se dikur ndodhi që dy karvanë me krushq, një në ardhje e një në kthim, u vunë përballë në rrugën e ngushtë. Asnjë nuk i hapi rrugë tjetrit dhe u... vranë, e u gurosën... por këto lloj ngatërresash kanë qenë të rralla në Dibër dhe legjendat e moçme tregohen me të qeshur...

Pazari i dajave për nusen

Sigurisht, që nuk mund të harronim në këtë shkrim, episodin e pazarit të dajës së nuses me dajën e dhëndrit dhe krushqit e tjerë...



Përballja mes dy dajave, loja e zgjuarsisë, këmbimet e batutave dhe një alegori e retorikë e mrekullueshme gjallonte në të tilla raste, e ndoshta dhe sot, por e reduktuar ndjeshëm, deri në zhdukje të këtij zakoni.

“Atje kishte një ndeshje mendimesh, intelekti dhe shpeshherë shoqërohej me një garë për trimëri e pasuri. “Në muhabet e sipër, fillonte daja i vajzës që kishte të drejtat e veta; Ai do të pyetej për vajzën, por edhe do të kërkonte. Daja i nuses e niste duke kërkuar një sasi të madhe lekësh. Pastaj fillonin shokët e vet, “Jo, jo se i kemi miq! I kemi të dashtun. Prandaj ule këtë vlerë...”. Më tej, dilte një shok tjetër i dajës së nuses dhe thoshte: “Prapë shumë e ke, ne do çojmë vajzën nuse aty, ndaj ule edhe pak”. Më në fund, arrinte që daja i dhëndrit jepte shumë pak, ndonjë peshqesh për atë që bënte kafen, ndonjë dhuratë tjetër për nusen dhe një bakshish të vogël për derën. Shumë pak ishin ata që nuk të falnin. Nuk ishte dëshirë e dibranit për të ngacmuar mikun. Shumë rrallë, miqtë dilnin të pakënaqur nga dhomat. Në këto momente shpalosej urtia e krushqve mes batutave dhe frazave shumë të matura që këmbenin me njëri-tjetrin, duke dashur të ulnin çmimin që daja i dhëndrit duhet t’i paguante dajës së nuses. Shprehjet përdoreheshin tepër alegorike dhe nuk ishin asnjëherë direkte: “Shqiponja ishte njëherë lart, por tani asht ul në një kep...”, - që do të thotë se kanë qenë kohëra më të mira, por tani daja i dhëndrit është keq ekonomikisht. Më tej, oratoria vazhdonte me shprehje të tjera: “Rrasa atje në një arë, por miqtë e mi nuk më rregullojnë groshët...”. Kur daja kërkonte lekë mund t’ia niste “shtëpia është t’u më ra...”. Ndërkaq hidhej një nga krushqit për ta zbutur dajën: “Vërtet është shtëpia duke të ra, por na ke ne, të ndihmojm na!”. Pastaj daja e kthente: “Më ndihmoni ju, por jeni larg”, ndërkaq dikush tjetër mund t’ia kthente dajës: “me burrat tanë bëhemi shumë, nja 1000 plita t’i pres unë...”. Por, ka pasur edhe raste kur krushqit nuk janë marrë vesh dhe daja i nuses ka kërkuar shumë lekë, aq sa krushqit e dhëndrit kanë mbetur pa nuse dhe janë detyruar të vijnë më pas, e ta marrin me forcë vajzën...

Nusja shikohej nga unaza

Para se nusja të hynte në shtëpi, dhëndri zinte një vend “strategjik” nga ku mund të shikonte gruan e tij të ardhshme.

Ndërkaq, dhëndri nxirrte unazën dhe e vinte në sy në mënyrë që ta shikonte nusen për herë të parë nëpërmjet saj. Pastaj, nusja ndalej te porta e shtëpisë dhe në dy krahët i futeshin bukët, pastaj kungujt. Teksa hynte brenda nusja, i hidhnin edhe një gjel mbi kokë. “Me një hatllagi (shkopi që hapen petët e byrekut) hoxha i ngre pastaj duvakun nuses.

Rritet kur hyn nusja tek dhëndri

Më tej, nusja hynte në shtëpinë e dhëndrit ku bëhej dasma me aheng të madh. Tri ishin veglat kryesore të muzikës; Çiftelia, lodra dhe curlja (vegël e ngjashme me gërnetën), ndërsa shumë më vonë u fut edhe violina. Ndërkaq, dilte dhëndri dhe qëllonte tri herë në një kodër me pushkë. Kuptimi ishte i disafishtë; Dhëndri është gjallë, por edhe që tani nusja dhe krushqit janë në mbrojtjen e tij. Nusja atë ditë vetëm rrinte e heshtur. Hedhja e orizit, grurit dhe vënja e bukëve në duart e nuses, nuk ishin fenomene fort të dukshme por megjithatë kryheshin. Nuses i vihet edhe raki që ta derdhë me këmbë, e cila është për të hequr të keqen bashkë me rakinë, e cila konsiderohet si një e keqe më vete. Bashkë me rakinë derdhet edhe një gotë e ujë, për të hequr syrin e keq dhe për t’i sjellë çiftit fat të mbarë. Por, derdhja e rakisë atje ku shkelte nusja, bëhej edhe për ta ruajtur nusen që të “mos ta zinte magjia”.

Nata e parë e dhëndrit me nusen

Atë darkë, kur nusja për herë të parë mbyllej pas darkës me dhëndrin brenda në dhomë, shokët e dhëndrit nga jashtë dhe në oborr, këndonin këngë ngacmuese duke e vënë në lojë dhëndrin e ri. Ata qeshnin me dhëndrin e hidhnin valle: “Pjergull o, moj pjergull o, i lë vetë beqarët në livadh, duke kullotur gomarët...”. Shokët ngacmonin me lloj-lloj batutash: “Dhëndër, mos e fal nusen për sonte...”. Por duhet pasur parasysh se të gjitha këto batuta këmbesheshin dhe thuheshin nga njerëzit e afërt, pra brenda gjakut, pasi në dasma nuk thërriteshin shokët e punës apo njerëzit që nuk ishin në fis. Teksa është ngjitur lart nëpër shkallë, për të shkuar i lumtur në natën e parë të tij me nusen, ai tregon se të gjithë tentonin ta gjuanin kush më lehtë e kush më fort. Këndonin te dera dhe pas 20 minutash futeshin nuset e dajës, daja dhe të afërm të tjerë dhe së bashku hanim petullat. Me ngrënien e petullave, ia niste nusja e pastaj dhëndri e më pas të gjithë të tjerët që i rrethonin. Pas kësaj, të afërmit ngriheshin dhe i linin vetëm nusen me dhëndrin.

Të nesërmen në mëngjes, ajo që duhej të zgjohej e para e shtëpisë dhe të dilte përjashta ishte nusja e re. Duke mbajtur përdore një djalosh 5-6 vjeçar, nusja shkonte tek çekzma e fshatit apo qytetit dhe mbushte ujë. Të paktën kështu ka qenë kjo traditë, deri vonë në Dibër...

Më tepër se një grua?

Martesa me shumë gra në fenë myslimane është e ndaluar kategorikisht. Por, ka një përjashtim; Në rast se gruaja e parë vdes, ke të drejtë të martohesh me të dytën, ose nëse gruaja e parë ka lindur 5 fëmijë dhe nuk është në gjendje t’ju shërbejë siç duhet, atëherë burrit i lind e drejta për të marrë një grua të dytë. Gjithmonë, kur merret pëlqimi edhe nga gruaja e parë, një kusht i vendosur nga feja islame për burrin, është që ai duhet të kujdeset në mënyrë të veçantë për të dyja gratë. Nëse i blen njërës një rrobë, duhet të bëjë të njëjtën gjë edhe me tjetrën, nëse i rregullon njërës një dhomë, duhet ta bëjë këtë gjë edhe për nusen tjetër. Pra, duhet t’i trajtojë gratë në mënyrë sa më të barabartë.

Në traditën dibrane vend të rëndësishëm zë dhe kulinaria dibrane, e cila është mjaft e pasur. Disa prej gatimeve të ruajtura me fanatizëm janë: Sheqerpare,

Shëndetlije, Jufka me Pulë Fshati, Kulloshtër n’tavë, Petllat e Malsis, Pulë me Arra, Pulë m’Qull, Hallvë Dibre, Fli’ me Renda, Bungur i Omël, kompostot e reçelnat e me kumlla, molla, thana ne qershi, etj.

Vetëm e famshmja hallvë Dibrane gatuhet gati në katër mënyra, me miell gruri, miell misri, me trahana dhe gështenja. Të gjitha këto gatime dibranët i ruajnë me fanatizëm, siç ruajnë dialektin e tyre të rrallë dhe natyrën e pashoqe.

EKSPERTËT E NATO-S DISKUTOJNË SFIDAT E PARANDALIMIT BËRTHAMOR NË HELSINKI

Simpoziumi vjetor i Politikës Bërthamore i NATO-s, i mbajtur çdo vit që nga viti 1992, ngjarja kryesore e politikës bërthamore të Aleancës, u zhvillua në Helsinki të Finlandës. Simpoziumi bashkon ekspertë të jashtëm, si dhe zyrtarë të lartë të NATO-s dhe Aleatëve për të diskutuar sfidat urgjente bërthamore me të cilat përballlet Aleanca.

“Simpoziumi i këtij viti po zhvillohet në një moment kritik për parandalimin bërthamor të NATO-s”, tha Z. Jim Stokes, Drejtori i Politikës Bërthamore i NATO-s, i cili bashkë-organizoi ngjarjen dy-ditore me Z. Janne Kuusela, Drejtor i Përgjithshëm për Politikën e Mbrojtjes në Ministrinë e Mbrojtjes së Finlandës. “Aleanca po përballlet me një mjedis sigurie gjithnjë e më kompleks dhe që ndryshon me shpejtësi. Aleatët e NATO-s përsërisin vendosmërinë e tyre për të ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar besueshmërinë, efektivitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e misionit të parandalimit bërthamor”, - u shpreh z. Stokes. “Rritja e ndërgjegjësimit tonë kolektiv për çështjet e politikës bërthamore dhe mundësia për të diskutuar implikimet është rezultati kryesor i simpoziумit”, - tha ai.

“Angazhimi i NATO-s dhe shteteve të saj anëtare për një pengesë dhe mbrojtje të besueshme dhe efektive tani është më i rëndësishëm se kurrë”, - tha Antti Häkkanen, Ministër i Mbrojtjes i Finlandës. Ai theksoi se Simpoziumi i Politikës Bërthamore mbështet arritjen e këtij qëllimi. “Ky është një aktivitet unik që rrit kuptimin tonë mbi temat kryesore në politikën bërthamore”, - shtoi Ministri Häkkanen.

Simpoziumi i Politikës Bërthamore i këtij viti trajton perspektivat e Veriut të Epërm mbi parandalimin, si dhe implikimet e kërcënimeve dhe sfidave bërthamore në të gjithë rajonet Euro-Atlantike dhe Indo-Paqësore.

Politika dhe forcat e NATO-s për parandalimin bërthamor

Armët bërthamore janë një komponent thelbësor i aftësive të përgjithshme të NATO-s për frenim dhe mbrojtje, së bashku me forcat konvencionale dhe ato të mbrojtjes nga raketat. NATO është e përkushtuar ndaj kontrollit të armëve, çarmatimit dhe mospërhapjes, por për sa kohë që ekzistojnë armët bërthamore, ajo do të mbetet një aleancë bërthamore.



strategjike.”

Aleanca riafirmon domosdoshmërinë për të siguruar pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme nga Aleatët e interesuar në marrëveshjet e dakorduara për ndarjen e barrës bërthamore për të demonstruar unitetin dhe vendosmërinë e Aleancës.

Rishikimi i Parandalimit dhe Qëndrimit të Mbrojtjes (DDPR) u miratua nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive Aleate në Samitin e Çikagos në vitin 2012. DDPR theksoi se qëllimi themelor i forcave bërthamore të Aleancës është parandalimi, i cili është në thelb një funksion politik. Ndërsa Aleanca përqendrohet në ruajtjen e parandalimit efektiv, kontrolli politik i armëve bërthamore do të mbahet në të gjitha rrethanat dhe planifikimi dhe konsultimi bërthamor brenda Aleancës do të jenë në përputhje me udhëzimet politike.

Konsultimi bërthamor

Parimet kryesore të politikës bërthamore të NATO-s përcaktohen nga të gjithë Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të NATO-s. Zhvillimi dhe zbatimi i politikës bërthamore të NATO-s janë përgjegjësi e Grupit të Planifikimit Bërthamor (NPG). NPG ofron forumin për konsultim mbi të gjitha çështjet që lidhen me parandalimin bërthamor të NATO-s. Të gjithë Aleatët - me përjashtim të Francës, e cila ka vendosur të mos marrë pjesë - janë anëtarë të NPG-së.

Roli i forcave bërthamore të NATO-s

